

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT**



**PUNIMI I DIPLOMËS - MASTER**

**VLERËSIMI I DISA KARAKTERISTIKAVE MORFOLOGJIKE DHE LËVIZORE  
BAZIKE E SITUACIONALE TEK NXËNËSIT E TË DY GJINIVE TË MOSHËS  
DYMBËDHJETË VJEÇARE TË RËNDËSISHME PËR LOJËN E BASKETBOLLIT**

Mentori:

Prof.dr. Hazir Salihu

Kandidati:

Nazmi Balaj

Prishtinë, 2015

# PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE .....</b>	<b>3</b>
<b>2. HULUMTIMET E GJERTANISHME.....</b>	<b>7</b>
2.1. HULUMTIMET E GJERTANISHME NË FUSHËN E MORFOLOGJISË.....	7
2.2. HULUMTIMET E GJERTANISHME NË FUSHËN E MOTORIKËS.....	8
<b>3. QËLLIMI I HULUMTIMIT .....</b>	<b>10</b>
<b>4. HIPOTEZAT THEMELORE .....</b>	<b>12</b>
<b>5. METODAT E HULUMTIMIT .....</b>	<b>13</b>
5.1 MOSTRA E ENTITETIT.....	13
5.2 MOSTRA E VARIJABLAVE.....	13
5.2.1. Variablat antropometrike.....	13
5.2.2. Variablat motorike.....	14
5.2.3. Mostra e variablave motorike specifike.....	14
5.3. MËNYRA E ZBATIMIT TË HULUMTIMIT.....	15
5.4. PROGRAMI DHE PROCEDURA E MATJES.....	15
5.4.1. Kushtet e matjes të parametrave antropometrik, motorik dhe motorike specifike.....	15
5.4.2. Pikat dhe nivelet antropometrike.....	16
5.4.3. Mjetet matëse antropometrike.....	17
5.4.4. Përshkrimi i instrumenteve matëse antropometrike.....	18
5.4.5. Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike.....	23
5.4.6. Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike specifike.....	26
5.5. METODAT PËR PËRPUNIMIN E REZULTATEVE.....	29
<b>6. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI.....</b>	<b>30</b>
6.1. TREGUESIT THEMELOR STATISTIKOR.....	30
6.1.1 Treguesit themelor statistikor të parametrave antropometrik dhe motorik te nxënësit.....	30
6.1.2 Treguesit themelor statistikor të parametrave antropometrik dhe motorik te nxënëset.....	33
6.2. REZULTATET E NDËRLIDHJEVE.....	36
6.2.1. Rezultatet e ndërlidhjeve ndërmjet variablave antropometrike te nxënësit.....	36
6.2.2. Rezultatet e ndërlidhjeve ndërmjet variablave antropometrike te nxënëset.....	38
6.2.3. Rezultatet e ndërlidhjeve ndërmjet variablave motorike dhe motorike-specifike te nxënësit.....	40
6.2.4. Rezultatet e ndërlidhjeve ndërmjet variablave motorike dhe motorike-specifike te nxënëset.....	42
6.3. MATRICA E KROSKORELACIONIT NDËRMJET VARIJABLAVE ANTROPOMETRIKE DHE ATYRE MOTORIKE E MOTORIKE-SITUACIONALE TE MESHKUJT.....	44
6.4. MATRICA E KROSKORELACIONIT NDËRMJET VARIJABLAVE ANTROPOMETRIKE DHE ATYRE MOTORIKE E MOTORIKE-SITUACIONALE TE FEMRAT.....	45
6.5. DALLIMET NË REZULTATET E VARIABLAVE ANTROPOMETRIKE, MOTORIKE DHE MOTORIKE-SPECIFIKE.....	46
6.6. DALLIMET NË REZULTATET E VARIABLAVE ANTROPOMETRIKE, MOTORIKE DHE MOTORIKE-SPECIFIKE.....	49
<b>7. VËRTETIMI I HIPOTEZAVE.....</b>	<b>50</b>
<b>8. PËRFUNDIMI.....</b>	<b>51</b>
<b>9. LITERATURA .....</b>	<b>53</b>

## 1. HYRJJE

Basketbolli bashkohor përmban kompleksitet të madhë dhe variabilitet të punëve motorike të cilat janë të orientuara në arritjen sa më të madhe të tempos, dinamikës dhe atraktivitetit, zhvillimit optimal të personalitetit të lojtarit e me këto edhe në sukseset sportive në gara. Efikasiteti në basketboll është i mundur vetëm atëherë nëse në mënyrë sistematike definojnë fenomenet të cilat janë të një rëndësie të veçantë primare për strukturimin e lëvizjeve themelore në lojën e basketbollit, ligjshmëritë e transformimeve orientuese dhe gjeneratorit primar të aktiviteteve kineziologjike. Basketbolli është sport kompleks të cilën e përbëjnë lëvizjet komplekse të thjeshta dhe të përbëra, dhe se këto lëvizje i ekzekutojnë anëtarët e ekipes në kushtet e bashkëpunimit si dhe kundërvënies ekipes kundërshtarë gjatë lojës. Me përjashtim, duhet patur parasyshë në gjendjen e aftësive motorike dhe funksionale dhe në karakteristikat morfologjike.

Meqenëse basketbolli është sport kompleksiv, parashtrohen kërkesa dukshëm të mëdha në këto karakteristika antropologjike të përmendura. Përpos vërtetimit të kontributit të çdo karakteristike antropologjike është me rëndësi të vërtetojmë edhe raportet optimale në mes të gjitha karakteristikave, me çrast fitohen informacionet mbi përgatitjen integrale. Basketbolli paraqet sport kompleks i cili nga dita në ditë gjithnjë e më tepër po zhvillohet. Grupi i lojtarëve me kualitete të ndryshme basketbollistike, temperamente, qëndrime, duhet të komponohet ashtu që të funksionojë si një tërësi, respektivisht, mekanizmi në të cilin secili e ka rolin e vet në rrugën drejt realizimit të qëllimit të caktuar. Gjatë zhvillimit të këtij sporti kujdes më i vacant iu është kushtuar teknikës, taktikës dhe përgatitjes fizike të basketbollistëve. Sot kur segmentet e përmendura më lartë të lojës së basketbollit kanë arritur deri në një shkallë të kënaqshëm apo të lakmueshme, mbizotrimi në konfliktet ndërmjet vete në ekipë sjellë kompaktitet (kohezion) ekipes. Në lojrat plotë emocione, me kthime në rezultate, presioni i publikut dhe fitorja si imperative, ekipa psikikisht stabile ka shansa më të larta për fitore. Ekipa e përbërë nga lojtarët me raporte interpersonalë të forta të inkuorporuara në motivin e lartë për fitore, do të ketë përparësi, e cila sa do që të duket minimale mund të sjell rezultat të dëshiruar.

Që të jetë ekipa kompakte dhe që lojtarët të realizojnë lidhje të forta emocionale, është e domosdoshme të punojmë gjatë dhe shumë, në stërvitje, bisedime dhe kshillime. Kjo është e mundur që të arrihet vetëm pas analizimit të strukturës sociometrike të ekipës, dhe konstatimi i situatës sociometrike momentale.

Basketbolli është specifik sipas asaj që shpeshë një gabim mund të vendos për rrjedhën e lojës. Nuk ekzistojnë shansat për përmirësim. Trenerët duhet të mbajnë nivelin e motivimit tek lojtarët e vet gjatë gjithë lojës ashtu që kundërshtari me rezultat mos të shmanget, ose ashtu që ekipa të mbaj përparësinë në rezultat ndaj ekipes kundërshtare. Shpesh në gara (gjatë lojës) mund të vërejmë oscilime të rezultatit, nga udhëheqja e dukshme deri tek ngecja evidente dhe anasjelltas. Në këto situata shikohet përgaditja fizike dhe psikologjike e ekipes, kohezioni, forca e ekipes dhe udhëheqja e mire e trenerit.

Në kohën e sotme, niveli i arritjes në sportin kulminant aq është i lartë sa që sportistët gjatë sistemeve të përgatitjes stërvitore mund të arrijnë ose ti tejkalojnë vetëm me anë të ngritjes më të madhe të efikasitetit stërvitor. Mirëpo, rritja e efikasitetit supozohet, jo vetëm rritja e sasisë së punës, por në rend të parë organizimin më të mirë të procesit stërvitor, zgjedhja më e mirë e mjeteve dhe metodave, renditja më racionale e punës dhe çlodhjes gjatë një procesi stërvitor, disa proceseve stërvitore, etapave dhe periudhave, dhe e gjithë këjo pandërprer duke u kujdesur për gjendjen e sportistit. Këto kërkesa mund të realizohen kryesisht gjatë udhëheqjes (kibernetike) optimale me proceset gjithëpërfshirëse pedagogjike në proceset stërvitore sportive.

Problemi kryesor në çdo sport, pra edhe në sportin e basketbollit është ai i orientimit dhe seleksionimit të rinjëve në moshën sa më të re. Orientimi i hershëm dhe i drejt në seleksionimin e rinjëve për këtë sport duhet të merr për bazë karakteristikat antropologjike të njeriut të cilat janë me ndikim të rëndësishëm në suksesin në arritjen e rezultateve sa më të mira në lojën e basketbollit. Nga gjitha karakteristikat antropologjike rol dhe ndikim të rëndësishëm në lojën e basketbollit kanë parametrat antropometrik e nga këto sidomos lartësia e trupit si dhe aftësitë psikomotorike.

Me dimensione motorike nënkuptojmë ato aftësi të njeriut të cilat marrin pjesë në kryerjen e detyrave motorike dhe kushtëzojnë lëvizje të suksesshme në të gjitha sportet (pra, edhe në sportin e basketbollit), pa marr parasysh se a janë fituar aftësitë me anë të trajningut apo jo. Në nivelin e tashëm të njohjes së shkencës në këtë hapsirë vërehet se dimensionet motorike në shumë hulumtime lajmërohen në mënyra të caktuara me detyra të ndryshme. Me aplikimin e analizës faktoriale zbulohen gjithë e më shumë faktor të cilët vërtetojnë ekzistimin e shumë faktorëve motorik siç janë: të forcës, shpejtësisë, koordinacionit, fleksibilitetit, dhe tjerë që ka sjellur deri te pyetja se sa dimensione motorike objektivisht ekzistojnë dhe çfarë është raporti ndërmjet tyre. Në bazë të hulumtimeve të cilat kanë pasur karakter taksonom në strukturën e hapësirës motorike (faktor të rendit të parë) janë definuar faktor të tipit akcional (forca, shpejtësia, fleksibiliteti, drejtpeshimi, koordinacioni dhe preciziteti) dhe faktor të tipit topologjik (forca e matur me dinamometër, forca eksplozive, forca repetitive e duarve dhe e kraharorit, forca repetitive e këmbëve, forca repetitive e trupit, forca statike e duarve dhe e kraharorit, forca statike e këmbëve, forca statike e trupit, të vërejturit preciz, gjuajtja precize, drejtpeshimi me sy të mbyllur, drejtpeshimi me sy të hapur, fleksibiliteti, shpejtësia e lëvizjeve të thjeshta, shpejtësia e frekuencionit, shpejtësia e të mësuarit të detyrave të reja motorike, koordinimi në ritëm, agjiliteti, riorganizimi stereotip i lëvizjeve, shpejtësia e ekzekutimit të detyrave komplekse motorike, koordinimi i tërë trupit, koordinimi i duarve, koordinimi i këmbëve).

Shumica e aftësive psikomotorike fitohen dhe zhvillohen kryesisht në periudhën e femijerisë. Në këtë periudhë të zhvillimit ndërtohet dhe zhvillohet struktura e hapësirës motorike ndërsa pas periudhës së pubertetit (15 – 18 vjeçare) fillonë të stabilizohet (Metikos, 1974, Kurelic me bashk., 1975, Bala, Kis dhe Popovic, 1996).

Në këtë fazë të zhvillimit me sukses i përvetësojnë elementet e teknikës sportive duke i ekzekutuar me një intensitet më të lartë, dhe se në këtë periudhë është e nevojshme një proces stërvitor më i avancuar (Duraskovic, 2002).

Orientimi dhe përcaktimi i rinisë për sportin e basketbollit është i kushtëzuar me dëshirën e vet të riut për këtë sport ose me anë të seleksionimit nga ana e ekspertit të lojës së basketbollit duke i marr parasysh karakteristikat morfologjike për këtë sport, aftësitë psikomotorike dhe kognitive si dhe shpejtësinë e të mësuarit dhe përsosjes së elementeve tekniko-taktike, (Fulgozi, 1994). Seleksionimi, përpos zgjedhjes që duhet bërë, nënkupton edhe orientimin dhe përsosjen e basketbollistëve talent dhe sportistëve potencial kulmor (Paranosic dhe Savic, 1977). Ky është një proces i gjatë dhe i ndërlikuar i cili kërkon punë ekipore dhe qëndrim multi disiplinor.

Basketbolli sipas karakteristikave të tyre i përket lëvizjeve polistrukturale komplekse ciklike dhe aciklike, dhe numërohet në kategorinë e sporteve atraktive. Suksesit në të gjitha sportet, pra edhe në atletikë, varet nga shumë faktorë ndërmjet veti të lidhura ndërmjet veti siç janë: karakteristikat antropometrike, aftësitë motorike, aftësitë kognitive, veçoritë konative, strukturës motivuese, karakteristikave fiziologjike-funksionale, dinamika e rrethit mikrosocial, elementeve tekniko-taktike. Të gjitha këto gërshetohen në strukturë të përbashkët përgjegjëse për rezultatin sa më të mirë në sportin e basketbollit.

Në këtë kontekst është i mundur përcaktimi i rolit të dimensioneve morfologjike dhe aftësive situaciono-motorike si subsistem i sportit (si sistem), dhe si komponentë programore e procesit transformues (Demir, 1998). Udhëheqja me këto procese është e mundur nëse në to në mënyrë konstante funksionon lidhja ndërmjet çdo nënsistemi (Gabrieliçi, 1977).

Karakteristikat e sportit të basketbollit janë lëvizjet shumë të shpejta me lëvizje eksplozive dhe të shumëfishta ciklike dhe aciklike të cilat kërkojnë aftësi komplekse të basketbollistit dhe shkallë të lartë të aftësive koordinuese, funksionale dhe kognitive të cilat janë baza e aksioneve të forta të shpejta dhe precize. Situatat e ndërlikuara gjatë lojës kërkojnë basketbollist të përgatitur, të aftë që detyrat tekniko-taktike gjatë lojës në mënyrë precize, me intensitet dhe kohë optimale ti realizojë.

## **2. HULUMTIMET E DERITANISHME**

Në këtë kapitull do të paraqiten hulumtimet e gjertanishme sipas vjetërsisë së hulumtimit dhe rëndësisë që e kanë në ndikimin në sportin e atletikës, edhe atë së pari do të paraqiten hulumtimet në fushën e antropometrisë, pastaj të motorikes dhe hulumtimet e ndërlydhjes.

### **2.1. HULUMTIMET E DERITANISHME NË HAPËSIRËN MORFOLOGJIKE**

**Me karakteristika morfologjike** të strukturës të statusit psikosomatik të njeriut nënkuptojmë sistem të caktuar të dimensioneve latente antropometrike pa marr parasysh atë se, a janë zhvilluar këto dimensione nën ndikimi e veçantë të rrethit të jashtëm (me stërvitje të caktuar) apo jo. Në pajtim me këtë, që të vërtetohen në mënyrë shkencore dimensionet latente të kësaj hapësire, zgjidhja është mbështetur në aplikimin e analizës faktoriale dhe analizës regressive.

H.Salihi., në vitin 2000, në punimin e Magjistraturës, ka testuar relacionet e disa karakteristikave trupore dhe aftësive motorike, bazike situacionale tek basketbollistët e moshës 14+ 6 muaj. Si model(mostër) e këtij punimi i cili përfshin 108 basketbollistë të rinj të gjinisë mashkullore, të qytetit të Prishtinës, ku për model të ndryshoreve ka morfologjinë dhe ka aplikuar 10 teste, dhe aftësive motorike situacionale (5) teste, dhe (5) teste tjera nga aftësitë motorike të përgjithshme apo bazike.

**Në kohën antike** janë bërë matje me qellim që ta shikojnë lartësin e trupit të ushtarëve.

**Në Qipro** matjet janë shfrytëzuar për ta shikuar proporcionalitetin e ndërtimit të statujave.

**Në vitin 1741 në Norvegji** janë bërë matjet e para të regrutëve pastaj ma vonë në Finlandë, Suedi dhe Rusi ku ka lulëzuar antropometria ushtarake.

## 2.2. HULUMTIMET E DERITANISHME NË HAPËSIRËN LËVIZORE

**Me dimensione motorike\*** nënkuptojmë ato aftësi të njeriut të cilat marrin pjesë në kryerjen e detyrave motorike dhe kushtëzojnë lëvizje të suksesshme, pa marr parasysh se a janë fituar aftësitë me anë të stërvitjes apo jo. Në nivelin e tashëm të njohjes së shkencës në këtë hapsirë vërehet se dimensionet motorike në shumë hulumtime lajmërohen në mënyra të caktuara me detyra të ndryshme. Me aplikimin e analizës faktoriale zbulohen gjithë e më shumë faktor motorik.

**Metikoš** (1973) ka analizuar baterinë prej 27 testeve të forces së duarve dhe kraharorit dhe ka arritur të izolojë dimensionet të diferencuara sipas tipit të ngarkesës. Këto i ka interpretuar si forca statike absolute dhe relative, forcën relative repetitive, dhe forcën shpërthyes absolute.

**Kurelic, N., Momirovic, K., Stojanovic, M., Sturm, J., Radojević, Gj. dhe Viskic-Srelac, N. (1975)** në mostrën prej 384 në tetë submostra të dy gjinive (gjithsejt 6144 të testuar) ndër të tjera kanë hulumtuar strukturën dhe zhvillimin e dimensioneve motorike të fëmijve dhe rinisë të moshës 11, 13, 15 dhe 17 vjeçare të dy gjinive në të cilin hulumtim janë aplikuar 37 teste motorike. Rezultatet e fituara e këtij hulumtimi tregojnë se janë izoluar faktorë motorik në aspektin aksional dhe tipologjik.

---

\*Me nocion dimensionet motorike nënkuptohen ato aftësi motorike (abilites), të cilat më herët (kahë fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX) janë quajtur «aftësi fizike» e më vonë «cilësi fizike», «kualitete lëvizore» e tjera.



Në bazë të hulumtimeve të këtyre autorëve të cilat kanë pasur karakter taksonom në strukturën e hapësirës motorike (faktor të rendit të parë) janë definuar faktor të tipit akcional (forca ,shpejtësia, fleksibiliteti, drejtpeshimi, kordinacioni dhe preciziteti) dhe faktor të tipit topologjik ( forca e matur me dinamometër, forca eksplozive, forca repetitive e duarve dhe e kraharorit, forca repetitive e këmbëve, forca repetitive e trupit, forca statike e duarve dhe e kraharorit, forca statike e këmbëve, forca statike e trupit, të vërejturit preciz, gjuajtja precize, drejtpeshimi me sy të mbyllur, drejtpeshimi me sy të hapur, fleksibiliteti, shpejtësia e lëvizjeve të thjeshta, shpejtësia e frekvencionit, shpejtësia e të mësuarit të detyrave të reja motorike, koordinimi në ritëm, agjiliteti, riorganizimi stereotip i lëvizjeve, shpejtësia e ekzekutimit të detyrave komplekse motorike, koordinimi i tërë trupit, koordinimi i duarve, koordinimi i këmbëve)

Këto hulumtime të cilat janë bazuar në modelet e funksionimit të sistemit nervor qendror gjatë ekzekutimit të detyrave motorike kanë treguar se faktorët që paraqesin modelin taksonom, mund ta paraqesin modelin kryesor hierarkik funksional i cili paraqet këto mekanizma të rendit të dytë:

**Mekanizmi për strukturimin e lëvizjes** – përgjegjës për variabilitetin e dimensionit të koordinacionit

**Mekanizmi për rregullimin e zgjatjes së ekscitimit** – përgjegjës për variabilitetin e dimensioneve të forcës statike dhe dinamike

**Mekanizmi për rregullimin e intensitetit të ekscitimit** – përgjegjës për variabilitetin e dimensionit të forcës eksplozive

**Mekanizmi për rregullimin e tonusit dhe rregullimit sinergist** – përgjegjës për variabilitetin e dimensioneve të shpejtësisë, fleksibilitetit dhe precizitetit.

Dhe faktorë të rendit të tretë paraqiten:

**Mekanizmi për rregullimin energjetik** (përfshin mekanizmin për rregullimin e intensitetit të ekscitimit dhe mekanizmin për rregullimin e zgjatjes së ekscitimit).

**Mekanizmi për rregullimin e lëvizjes** (përfshin mekanizmin për rregullimin sinergist dhe rregullimin e tonusit si dhe mekanizmin për strukturimin e lëvizjes).

**Mekić (1984)**, në mostrën prej 168 të testuarve të moshës 13 vjeçare ka aplikuar 24 variabla për vlerësimin e aftësive psikomotorike dhe 6 teste situaciono-motorike. Pas përpunimit të rezultateve është vërtetuar se instrumentet matëse të zgjedhura për matjen e aftësive primare motorike kanë ndikim të rëndësishëm në hapësirën latente dhe manifeste dhe paraqesin faktorë të rëndësishëm në seleksionimin sportistëve të testuar.

**S. Sekereš (2000)**, thekson seforca në sporte veçanarisht në basketboll manifestohet përmes katër formave e dhe atë: forca absolute, forca e shpejtësisë, forca eksplozive dhe qëndrueshmëria në forcë. Forca eksplozive është njëri ndër aftësitë më të rëndësishme motorike për basketbollistët kulminant.

### 3. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi i këtij hulumtimi është të konstatojmë karakteristikat kryesore antropometrike dhe motorike të nxënësve të moshës 12 vjeçare të dy gjinive të rëndësishme për lojën e basketbollit. Më konkretisht qëllimet e këtij hulumtimi janë: Në kuadër të vendosjes së këtillë të qëllimit të përgjithshëm, qëllimi i veçantë është që të vërtetohet niveli i lidhshmërisë së hapësirës antropometrike dhe motorike.

- Vërtetimi i karakteristikave dimensioneve trupore dhe dimensioneve motorike tek grupi i djemëve,
- Vërtetimi i karakteristikave dimensioneve trupore dhe dimensioneve motorike tek grupi i vajzave,
- Vërtetimi i lidhmërive korelative në mes të karakteristikave trupore dhe motorike tek djemtë dhe vajzat të rëndësishme për orientim në basketboll.

#### **4. HIPOTEZAT THEMELORE**

Në bazë të lëmisë dhe problemit të hulumtimit, në harmoni me qëllimin dhe metodat statistikore për përpunimin e të dhënave janë të vendosura hipotezat në vijim:

**H<sub>1</sub>** – Supozohet se ekzistojnë korelacione të rëndësishme në mes të variablave antropometrike dhe motorike tek dy grupet

**H<sub>2</sub>** – Supozohet se ekzistojnë dallime të theksuara në mes grupit të djemëve dhe vajzave në hapsirën antropometrike.

**H<sub>3</sub>**–Supozohet se ekzistojnë dallime të theksuara në mes grupit të djemëve dhe vajzave në hapsirën motorike.

## **5. METODAT E HULUMTIMIT**

### **5.1 MOSTRA E ENTITETEVE**

Mostra e entiteteve ka qenë e selektuar , në të cilën janë përfshirë 95 nxënës (50 nxënës të gjinisë mashkullore dhe 45 nxënës të gjinisë femrore). Mosha e të testuarve është  $12 \pm 6$  muaj, nga Shkolla fillore “Martin Camaj” të Gurakocit komuna Istog. Të gjithë nxënësit kanë qenë vijues të shkollës së basketbollit pranë shkollave përkatëse.

### **5.2 MOSTRA E VARIJABLAVE**

#### **5.2.1. Variablat antropometrike**

Për përcaktimin e hapësirës antropometrike janë përdorur 5 (pesë) variabla:

1. Lartësia e trupit .....**ALART**
2. Gjatësia e krahut.....**AGJKR**
3. Gjatësia e këmbës.....**AGJKE**
4. Gjatësia krahëhapur horizont.....**AGJKH**
5. Pësia e trupit.....**APESH**

### **5.2.2. Ndryshoret lëvizore**

Për përcaktimin e hapësirës motorike janë përdorur 3 (tri) variabla:

1. Vrapim 20 m starti i lartë.....**MV20L**
2. Kërcim nga vendi në largësi .....**MKLRV**
3. Kërcimi nga vendi në lartësi .....**MKLAV**

### **5.2.3. Mostra e variablave motorike specifike**

Për përcaktimin e hapësirës motorike specifike janë përdorur 2 (dy) variabla:

1. Hudhja e topit të mbushur medicinal në largësi nga niveli i gjoksit.....**MHMLGJ**
2. Driblim në mes pengesave 20m .....**MDP20M**

### **5.3. MËNYRA E ZBATIMIT TË HULUMTIMIT**

Matjet janë zbatuar gjatë vitit 2015 nga ekipi i trajnerve të shkollës së basketbollit, të ushtruar dhe të përgatitur për këtë hulumtim. Variablat antropometrike janë matur në orët e paraditës, ndërsa ato motorike dhe motorike specifike në orët e pasditës, në stërvitjet e organizuara nga shkolla e basketbollit. Të gjitha matjet janë organozuar në sallën e edukatës fizike. Testet janë krye në grupe të vogla nxenësish, ku se pari testin e ka edemonstruar trajneri në mënyrë që nxenësit ta kuptojnë më mirë detyrën e parashtruar.

### **5.4. PROGRAMI DHE PROCEDURA E MATJES**

#### **5.4.1. Kushtet e matjes të parametrave antropometrik, motorik dhe motorike specifike**

1. Matjet antropometrike janë ekzekutuar në orët e paraditës kurse ato baziko-motorike në orët e pasditës.
2. Instrumentet matëse kanë qenë të punimit standard dhe kanë qenë të bazhduara së paku çdo ditë para matjeve.
3. Vendi ku janë ekzekutuar matjet ka qenë hapsirë e mjaftueshme dhe e ndriçuar mirë, ndërsa temperature e ajrit rreth 22°.
4. Të testuarit para matjes kanë qenë zbathur dhe vetëm në brekë.
5. Dimensionet e caktuara antropometrike çdo herë i ka matur i njëjti testues.
6. Rezultatet e matjes janë lexuar gjatë kohës deri sa testuesi ka matur, ndërsa personi i cili shkruar rezultatet për ti kontrolluar i ka përsëritur rezultatet me zë të qartë
7. Matjet e segmenteve çift të trupit janë ekzekutuar në anën e majtë të trupit.
8. Matjet antropometrike janë përsëritur nga tri here.

#### **5.4.2. Pikat dhe nivelet antropometrike**

Pikat dhe nivelet antropometrike, të cilat para matjes në mënyrë precize janë caktuar dhe me laps demografik janë shënuar, kurse janë të domosdoshme për këtë program të matjeve:

1. Rrafshi i Frankfurtit – vija e cila e bashkon skajin e poshtëm të orbitës së majtë dhe skajin e epërm të vrimës së veshit jashtëm.
2. Pika e epërme e përparme e legenit (spina iliaca anterior superior).
3. Pika e jashtme e akromionit
4. Skaji i gishtit të mesëm



### 5.4.3. Mjetet matëse antropometrike

Për aplikimin e këtij programi të matjeve janë shfrytëzuar këto mjete antropometrike:

1. Peshorja (transportabile) e cila mundëson matjen me saktësi prej 0,5 kg dhe tek e cila ekziston mundësia. Peshorja bazohet çdo ditë para përdorimit dhe pas çdo dhjet matjeve.



2. Antropometri sipas Martinit për matjen e lartësisë së trupit



3. Antropometri për matje gjatësisë së krahut

#### 4.4.4 Përshkrimi i instrumenteve matëse antropometrike

Parametrat antropometrik janë matur sipas mënyrës siç vijon\*:

**APESH** - Pësja e trupit është matur me peshoren me sustë e cila mundëson saktësinë e matjes prej 0.1 kg, treguesi rregullohet në pozitën zero. E domosdoshme është që peshorja të vëhet në pozitë horizontale. I testuari është i zbathur, në brekë të shkurtëra, qëndron i qetë, në këmbë, në mes të peshores. Pasi që treguesi në peshore të qetësohet, rezultati lexohet me saktësi prej 0.1 kg.



---

\*Të gjitha matjet janë ekzekutuar sipas metodës të cilën e ka propozuar IPB (International Biologic Program) Programi biologjik ndërkombëtar, ndërsa parametrat e treguesve antropometrik janë matur sipas procedurës të cilat i kanë përpunuar M. Srojanovic dhe Z. Stojkovic (në bazë të pasqyrës së Stoudt dhe Mc Farlantit). PBN (Programi biologjik ndërkombëtar) ka përgatitur listën e matjeve antropometrike duke e pasur parasysh nevojën e atyre që merren me hulumtime të karakteristikave të trupit të njeriut në kushte të ndryshme e që shpesh nuk janë antropolog. Nga lista e matjeve antropologjike të propozuara nga Programi biologjik ndërkombëtar, gjithsejtë 39 matje, për nevojat e këtij hulumtimi janë përdorur 18 matje antropometrike (nga katër matje të çdo dimensionit morfologjik përpos matjeve transversale dhe indit dhjamor nga pesë matje).

**ALART – Lartësia e trupi** është matur me antropometër. Me rastin e matjes i testuariduhet të jetë i zbathur, në brekë dhe të qëndrojë në bazë të fortë horizontale. Koka duhettë ketë atë pozitë ku arrihet horizontalja e Frankfurtit (skaji i poshtëm i syrit dhe skaji iepërm i zgavrës së jashtme të veshit të jenë në pozitë horizontale). Qëndrimi i trupitduhet të jetë i drejtë, shputat e bashkuara. Testuesi qëndron në të majtë të të testuarit, pasiqë kontrollon pozitën e të eksperimentuarit dhe vendosjen e instrumentit, lëshonhorizontalen e antropometrit deri në pjesën parietale të kokës. Rezultati lexohet mesaktësi 0.1 cm.



**AGJDO – Gjatësia e dorës** është matur me antropometër të shkurtuar. I testuari qëndron drejt, me dorë dhe shuplakë të shtrirë, lehtësisht të larguar nga trupi. Njëri skaj i antropometrit vendoset në majë të gishtit të mesëm të dorës së majtë, kurse tjetri skaj (atyku lexohet rezultati) në zgjatimin shpatullor (processus acromialis) të anës së njëjtë. Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.



**AGJDDH – Gjatësia e duarve hapur** është matur me antropometër të shkurtuar. I testuari qëndron drejt, me duar dhe shuplakë të shtrira në pozitë horizontale. Njëri skaj i antropometrit vendoset në majë të gishtit të mesëm të dorës së djatht, (aty ku lexohet rezultati) ndërsa skaji tjetër i antropometrit mbështetet për muri ku është i vendosur maja e gishtit të mesëm të dorës së majt. Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.



**Gjatësia e këmbës** është matë me antropometër sipas Martinit. Gjatë matjes i testuari i zbathur dhe me brekë të lëshuara, qëndron në drejtqëndrim me shputa të bashkuara në bazën e rrafshët të antropometrit. Maja e akrepit të antropometrit vendoset në anën e majtë të përparmë të kokërdhokut (spina iliaca anterior superior) dhe lexohet lartësia e sajë nga baza horizontale e antropometrit. Rezultati lexohet me saktësi prej 0.1cm.



## 5.4.5 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike

### 1. Kërcim nga vendi në largësi – MKLRV

**Instrumentet:** Dysheku i gjimnastikës dhe metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

#### **Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari qëndron i kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit në pozitë drejtëqëndrimi me këmbë të thyera në gjuhë që mundëson kërcim më të sukseshëm.

**Realizimi i detyrës:** I testuari kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave

(pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

**Vlerësimi:** Matet largësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.



## **2. Kërcim nga vendi në lartësi – MKLAV**

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

Përshkrimi i detyrës:


Pozita fillestare: I testuari vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjërësi të legenit. I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht , kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë , i testuari kërcen vertikalishtë në lartësi (tre tentime) lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Realizimi i detyrës: I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalishtë, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë , i testuari kërcen vertikalishtë në lartësi (tre tentime). lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm. Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.



Udhëzime të testuarit: Të testuarve udhëzimet iu epen gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. I testuari bënë disa tentime provuese.



### 3. Vrapim 20 metra nga starti i lartë – MV20L

**Instrumentet:** Kronometri me 1/10 sek.

**Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari përgatitet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

**Realizimi i detyrës:** I testuari pas sinjalit për nisje duhet të vrapoj me shpejtësi maksimale deri në vijën e caktuar, matet koha nga momenti i nisjes e deri në momentin kur i testuari me krahëror kalon rrafshin vertikal mbi vijën e caktuar.

**Vlerësimi:** Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e caktuar. Koha matet në saktësi 1/10 sec.

**Udhëzime të testuarit:** Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. Të testuarit udhëzohen që pas arritjes në vijën e caktuar të vazhdojnë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.



#### **5.4.6 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike specifike**

##### **1. Driblim në mes pengesave 20m – MDP20M**

**Instrumentet:** Topi i basketbollit, pengesat e plastikës

**- Përshkrimi i detyrës:**

**- Pozita fillestare:** I testuari qëndron në pozitë të drejtqëndrimit, fytyrë nga drejtimi i ekzekutimit të detyrës, me këmbë të zgjëruara në nivel të kërdhokullave dhe mban topin me dy duar në nivel të gjoksit.

**- Realizimi i detyrës:** I testuari nga pozita e drejtqëndrimit me fytyrë nga drejtimi i ekzekutimit të detyrës në shenjën e pipitfillon sa më shpejt ta udhëheq topin në mes të pengesave të largësia 20 metra. Detyra përsëritet dy herë. Matësi qëndron në pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë dhe të shikohet rregullsia e udhëheqjes ose ekzekutimit të detyrës.

**- Vlerësimi:** Shënohet rezultati më i mirë i ekzekutimit i shprehur në të dhjetat e sekondes.

- **Udhëzime të testuarit:** Të testuarit iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. U tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.



## 2. Hudhja e medicinbollit në largësi nga niveli i gjoksit – MHMLGJ

**Instrumentet:** topi medicinal i peshës 3 kg, metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për hedhjen e topit medicinal

- **Përshkrimi i detyrës:**

- **Pozita fillestare:** I testuari qëndron në pozitë të drejtqëndrimit, fytyrë nga drejtimi i shtytjes së topit medicinal, me këmbë të zgjëruara në nivel të kërdhokullave dhe mban topin me dy duar në nivel të gjoksit.

- **Realizimi** i detyrës: I testuari nga pozita e drejtqëndrimit me fytyrë nga drejtimi i shtytjes hedhë topin medicinal sa ma larg që është e mundur. Detyra përsëritet dy herë. Matësi qëndron në pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë dhe të shikohet rregullsia e hedhjes.

- **Vlerësimi:** Shënohet rezultati i hedhjes e shënuar me centimetra. Pika zero është në fillim të hedhjes, saktësia e matjes 0,5 cm.

- **Udhëzime të testuarit:** Të testuarit iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. U tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.



## **5.5. METODAT PËR PËRPUNIMIN E REZULTATEVE**

Në bazë të qëllimit dhe hipotezave të parashtruara, janë aplikuar metodat e përpunimit të rezultateve të cilat mundësojnë sigurimin e informatave të mjaftueshme për realizimin e qëllimit.

Për të dy grupet e sistemit të variablave do të llogariten parametrat themelorë statistikorë dhe të shpërndarjes për secilën variabël, si dhe masat e asimetrisë dhe të shpërndarjes normale.

Vlerat minimale dhe maksimale ( R.min-R.maks)

Mesatarja aritmetikore (Ma)

Devijimi standard(Ds)

Parametrat e asimetrisë (SKEW dhe KURT)

**Raportet e ndërlidhjeve** ndërmjet variablave në hapësirën manifeste, si dhe korrelacionet ndërmjet sistemit të variablave.

**Për vërtetimin e dallimeve** ndërmjet dy grupeve grupit të djemve dhe grupit të vajzave në parametrat antropometrik, testet motorike dhe specifike-motorike është aplikuar analiza e variancës për dy grupet e pavarura, domethënë, dallimi në mes grupeve në mesataret aritmetikore është bërë përmes analizës discriminative **Paired-SamplesT – testit**.

Përpunimi statistikor i të dhënave do të përpunohet në bazë të programit statistikorë SPSS12.0.

## **6. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI**

### **6.1. TREGUESIT THEMELOR STATISTIKOR**

#### **6.1.1 Treguesit themelor statistikor të parametrave antropometrik dhe motorik te meshkujt**

Në tabelën 1 janë paraqitur parametrat themelor statistikor të parametrave antropometrik dhe motorik te meshkujt e moshës 12 vjeçare, ku janë të paraqitura vlerësimet e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet).

Mesatarja aritmetikore e variablës antropometrike, lartësia e trupit (ALART) është 151.08 cm. Rezultati minimal (134.40 cm) dhe ai maksimal (162.20 cm) i kësaj variable tregon për një dallim të theksuar në mes të entiteteve. Edhe pse ekzistojnë dallime të theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) kjo tregon se nuk ka shmangie të rëndësishme prej distribucionit normal.

Mesatarja aritmetikore e variablës antropometrike, gjatësia e krahut (AGJKR) është 62.20 cm. Rezultati minimal (54.80 cm) dhe ai maksimal (68.80cm) i kësaj variable tregon për një dallim të theksuar në mes të entiteteve. Edhe pse ekzistojnë dallime të theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) kjo tregon se nuk ka shmangie të rëndësishme prej distribucionit normal.

Karakteristika e përbashkët e dy variablave antropometrike të radhës të gjatësisë duarve krah hapur (AGJKE) dhe gjatësisë së këmbës (AGJDU) është se i përkasin dimensionit longitudinal. Vlerat e fituara të këtyre karakteristikave tregojnë se rezultatet e fituara nuk kanë veçanti të theksuar, këtë e shohim në bazë të rezultateve të fituara të parametrave të shpërndarjes Skewness dhe Kurtosis.

Shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucioneve të fituara të këtyre dy variablave tregojnë se nuk kanë shmangie të rëndësishme prej distribucionit normal dhe çon në përfundim se subjektet nuk dallohen shumë në mes veti në këto dy parametra antropometrik.

Mesatarja aritmetikore e variablës antropometrike, pesha e trupit (APESH) është 46.90kg. Rezultati minimal (30.15 cm) dhe ai maksimal (65.40cm) i kësaj variable tregon për një dallim të theksuar në mes të entiteteve. Edhe pse ekzistojnë dallime të theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) kjo tregon se nuk ka shmangie të rëndësishme prej distribucionit normal.

Mesatarja aritmetikore e variablës motorike, vrapim në 20 m (MV20L) nga starti i lartë është (3.92sek). Rezultati minimal (3.20 sek) dhe ai maksimal (4.30sek) i kësaj variable tregon se nxënësit nuk kanë dallim të theksuar në mes veti. Kjo tregon se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk ka shmangie të rëndësishme prej distribucionit normal.

Mesatarja aritmetikore e variablës motorike, kërcim së largu nga vendi (MKLRV) është (1.49cm). Rezultati minimal (1.18cm) dhe ai maksimal (1.89 cm) tregon se edhe pse ekzistojnë dallime të theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk ka shmangie të rëndësishme prej distribucionit normal.

Variabla motorike e radhës, kërcim së larti nga vendi (MKLAV) ka mesatare aritmetikore (32.78cm). Rezultati minimal (26.0 cm) dhe ai maksimal është (40.00 cm). tregon se ekzistojnë dallime i theksuar në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, dhe nga kjo shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk ka shmangie të rëndësishme prej distribucionit normal.

Variabla motorike e radhës, që është emruar si testi motorik specifik e që karakterizohet me hudhje apo shtytje të medicinbollit nga vendi prej nivelit të (MHMLGJ) ka mesatare aritmetikore (3.19cm).

Rezultati minimal (2.57 cm) dhe ai maksimal është (4.49 cm). tregon se ekzistojnë dallime i theksuar në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, nga kjo shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) kanë shmangie të rëndësishme prej distribucionit normal.

Variabla motorike e radhës, që gjithashtu është emruar si testi motorik specifik e që karakterizohet me udhëheqje të topit cik-cak të basketbollit me dorë në një distancë prej 20 metrava (MDP20M) ka mesatare aritmetikore (5.83sek). Rezultati minimal (5.06sek) dhe ai maksimal është (6.74sek). tregon se ekzistojnë dallime i theksuar në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal. Edhe pse ekziston një dallim i theksuar në mes rezultatit minimal dhe maksimal nga kjo shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk kanë shmangie të rëndësishme prej distribucionit normal.



**Tabela 1. Parametrat themelor statistikor të variablave antropometrike dhe motorike te meshkujt e moshës 12 vjeçare**

Descriptive Statistics

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis
ALART	50	134.40	162.20	151.08	6.31	-.690	.519
AGJKR	50	54.90	68.80	62.20	3.55	-.126	-.666
AGJKE	50	73.80	88.30	80.72	3.72	-.120	-.667
AGJDU	50	135.20	163.70	152.63	6.37	-.731	.834
APESH	50	30.15	65.40	46.91	8.29	.153	-.092
MV20L	50	3.20	4.70	3.92	.343	.379	.520
MKLRV	50	1.18	1.89	1.49	.168	.243	-.354
MKLAV	50	26.00	40.00	32.78	3.99	-.074	-1.147
MHMLGJ	50	2.57	4.49	3.19	.427	1.324	1.534
MDP20M	50	5.06	6.74	5.83	.445	-.354	-.398

**6.1.2 Treguesit themelor statistikor të parametrave antropometrik dhe motorik te femrat**

Në tabelën 2 janë paraqitur parametrat themelor statistikor të parametrave antropometrik dhe motorik te femrat e moshës 12 vjeçare, ku janë të paraqitura vlerësimet e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet).

Mesatarja aritmetikore e variablës antropometrike, lartësia e trupit (ALART) është 153.42 cm. Rezultati minimal (136.40 cm) dhe ai maksimal (163.20 cm) i kësaj variable tregon për një dallim të theksuar në mes të entiteteve. Edhe pse ekzistojnë dallime të theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) kjo tregon se nuk ka shmangie të rëndësishme prej distribucionit normal.

